



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr.2991/1Prot.

Tiranë më 21.06.2018

VENDIM

Nr. 20, datë 21.06.2018

“Për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” në “Zgjidhje e konflikteve me ndërmjetësim”, për vitin akademik 2018-2019”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 7; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, gërma “dh”; neni 75, pika 6, gërma “a”; Udhëzimin Nr.31, datë 29.12.2017, Kreu I, pikat 1 dhe 2; Kreu II, pika 1; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 19, pika 1; neni 20; si dhe në propozimin e Fakultetit të Shkencave Sociale me shkresën Nr.167/5 Prot., datë 14.06.2018, Senati Akademik i Universitetit të Tiranë në mbledhjen e dates 21.06.2018:

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” në “Zgjidhje e konflikteve me ndërmjetësim” me 60 kredite, në Departamentin e Sociologjisë të Fakultetit të Shkencave Sociale të UT-së.
2. Të përcillet në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë propozimi dhe dokumentacioni i plotë, për vijimin e procedurave miratuese për këtë program studimi.

KRYETARI

PROF.DR. MYNYR KONI